



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut

Opština Kacanik

Municipal Kacanik

-Shërbimi i kuvendit-

01Nr.60/01-27447 /19

Kaçanik, 12.09.2019

PROCESVERBAL

Dëgjimi publik i organizuar nga Kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Shërbime Publike dhe Komitetin për Komunitetet, lidhur me buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2020 dhe vlerësimet për vitet 2021-2022. Takimi është mbajtur me datë 12.09.2019 (e Enjte) me fillim pune në ora 11:00, në Restorant "Beni".

Në takim ishin të pranishëm : Kryesuesi i Kuvendit, z. Kemal Mërseli, anëtari i KPF-së: Nexhat Loku , kryesuesi i Komitetit për Shërbime Publike, z. Hamit Guri. Nga ekzekutivi i komunës morën pjesë : Nënkryetari i Komunës, z. Ylber Bajra, Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, z. Bahri Selimi, Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencia , Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, z. Ukshin Çallaku dhe drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Fatmir Loku.

Në takim ishin të pranishëm administratorë të fshatrave, qytetarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Kemal Mërseli, Të gjitha takimet publike janë organizuar me qëllim të rritjes së gjithë përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje si dhe në rritje të transparencës buxhetore.

Drejtori i DEFZH-s, z. Bahri Selimi, Ju përshëndes dhe ju prezantoj buxhetin e vitit 2020. Buxheti i komunës së Kaçanikut për vitin 2020 është në vlerë 9,000,530.00€. Kërkojë nga të pranishmit të diskutojmë nëse kemi mundësi që në bazë të kërkesave të bëjmë ndonjë lëvizje të mjeteve, gjithmonë duke u nisur nga kërkesat e arsyeshme, të heqim një projekt dhe të futet një projekt tjetër.

Kërkesat e qytetarëve:

Ramadan Dema - fshati Bob

Për fshatin Bob janë përcaktuar 20 mijë euro, kërkojmë intervenim në rrugën deri tek varrezat, ndërsa kërkojmë investime në rrugën deri tek Kulla e Hasanit.

Besnik Dema- Bob- nga shuma që është ndarë për fshatin Bob, të shtrohet me trotuar nga xhamia e fshatit deri tek oborri i shkollës, ndërsa me vazhduar me rregullimin e rrugës

deri tek dalja afër Viva Fresh. Poashtu kërkojmë rregullimin e rrethojës së oborrit të shkollës në këtë fshat.

Labinot Guri – Për fshatin Nikaj nuk ka asgjë të paraparë me buxhet diçka konkrete, kemi dy kërkesa për rregullimin e rrugëve që janë pasojë e Bechtel Enkës, si dhe rregullimin e rrugës që ka mbet në gjysmë që lidh dy pjesët e fshatit, si dhe rregullimi i rrugës “UCK”, të intervenohet si dhe të kyçet kanalizimi dhe ujësjellësi, si dhe të investohet në fshat edhe me fondin e ndriçimit publik, pra të ndriçohet fshati Nikaj.

Administrator nga fshati Shtrazë- kemi shumë kërkesa, nuk ceket asnjë investim përveç investimit qeveritar që ka me u realizuar për ujërat e zeza, kemi nevojë për ndonjë fushë sportive, ndonjë kënd të lojërave për fëmijë dhe sqarim rreth projektit të turizmit apo mbrohet kjo pjesë nga komuna.

Kjani Sallahu- kemi kërkesa urgjente kërkojmë implementimin të shpejt. Fshati Biqec ka nevojë për rregullim të infrastrukturës rrugore, asfaltimi i disa rrugicave, ende disa lagje nuk kanë asfalt, lagjja Zharku ende nuk ka qasje me rrugën kryesore të fshatit. Ka mbet një pjesë ende pa u asfaltuar rregullimi i disa defekteve neper rrugë, rregullimi i disa përroskave, një lokacion i rrezikshëm nga vërshimet, kemi nevojë për rehabilitim të ujësjellësit të fshatit, kemi intervenu pak me mjete vetanake të fshatit, nuk ka ujë të mjaftueshëm, kanali i ujitjes është blloku si pasojë e punëve të Bechtel Enkas, mirëmbajtja e gropave septike dhe kanalizimet fekale.

Fadil Vishi- Administrator i fshatit Dubravë- Jemi mirënjohës për arritjet por ende ka nevoja, kanalizimi fshatrave të grumbullohet me një gyp të vetëm, rregullimi i shtrati të Rekës së fshatit

Përfaqësues nga f.Ivajë- Nuk parashihet projekti për ujësjellës dhe kanalizim, rrugët e lagjes të f.Ivajë të asfaltohen.

Procesmbajtëse
Fatlume Guri



Kryesues i Kuvendit
Kemal Mërseli